

VENDIM
Nr. 242, datë 20.4.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 234, DATË 20.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet I dhe II, të vendimit nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja I

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Klasa e pagës	Paga bazë mujore për klasë
1	I	40 000
2	II	41 000
3	III	41 800
4	IV	42 500
5	V	43 000
6	VI	44 000
7	VII	45 500
8	VIII	46 300
9	IX	47 000

Lidhja II

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Klasa e pagës	Paga bazë mujore për klasë
1	I	40 000
2	II	41 000
3	III	41 800
4	IV	42 500
5	V	42 800
6	VI	43 200
7	VII	43 600
8	VIII	44 100
9	IX	44 800
10	X	45 300

11	XI	45 700
12	XII	46 000
13	XIII	46 700

VENDIM
Nr. 245, datë 20.4.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE TË TJERË ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) krerët 1/AP deri 1.10, të lidhjes nr. 1, zëvendësohen përkatësisht me krerët me të njëjtët numra dhe emërtime, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) krerët 2.1 deri 2.7, të lidhjes nr. 2, zëvendësohen me krerët me të njëjtët numra dhe emërtime, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

c) lidhja nr. 4 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) lidhja nr. 5 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) lidhja nr. 7 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

dh) lidhja nr. 8 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

e) lidhja nr. 9 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ë) lidhja nr. 10 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

f) pika 10/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10/1. Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, që shërbejnë në institucionet shëndetësore, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave është, si vijon:

“10/2. Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, që shërbejnë pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen nga:

a) fondi për politikën e reja të pagave, fondi i miratuar i kontingjencës, si dhe fondet e akorduara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për punonjësit e sistemit të kësaj ministrie;

b) fondet e miratuara të kontingjencës, për vitin 2023, për punonjësit e sistemit të Ministrisë së Drejtësisë;

c) fondet e miratuara për vitin 2023 për sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, për punonjësit e sistemit të kësaj ministrie.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku